

25. Dëgjuesit e programeve ruse dhe ukrainase "Shpresë për ty" në këto vende, por edhe në Bjellorusi, Gjermani dhe më gjerë. Shumë janë të vetmuar, por marrin paqe nga programet. Lutuni që anëtarët e familjeve të tyre do të përjetojnë shpresën dhe dashurinë e Jezusit.

26. Gratë ruse që martohen me burra jo të krishterë dhe shpresojnë t'i sjellin ata te Perëndia. Shpesh rezulton me pasoja të trishtueshme siç janë familjet e shkatërruara dhe marrëdhëniet e thyera me Perëndinë.

27. Familjet e ndara për shkak të betejave ekonomike që detyrojnë shumë të papunë të kërkojnë punë jashtë vendeve të tyre, duke i lënë fëmijët e tyre me gjyshërit ose të tjerët.

28. Romët në Sllovaki që vuajnë shumë. Shumë breza bashkë ndajnë kasolle me një dhe dy dhoma ose apartamente që nuk kanë ujë dhe energji elektrike.

29. Të krishterët në Ukrainë që të përgatiten më mirë për të trajtuar perspektivat laike mbi abortin, evolucionin, martesat brenda të njëjtës gjini, divorcin dhe çështjet e tjera familjare që kërcënojnë të ardhmen e fëmijëve të tyre.

30. Gratë në Ukrainë që po luftojnë për t'u kujdesur për familjet e tyre, sepse lufta ka vrarë bashkëshortët, baballarët, bijtë ose vëllezërit që ishin burim i të ardhurave në këto familje.

31. Fondet dhe planifikimin që nevojitet në mënyrë që liderët nga shumë vende të mund të marrin pjesë në Konferencën "Shpresë për ty" në Shtator ku të inkurajohen dhe të pajisen për punën e tyre.

Shumë gra në Evropën Qendrore dhe Lindore përjetojnë pasojat shkatërruese të varfërisë. Dhuna në familje, divorci, martesat në moshë të vogël dhe çështje të tjera sociale i drejtojnë njerëzit të kthehen tek alkooli, droga, bixhozi, dhe okulti në përpjekje të kota për të çliruar veten nga dhimbja dhe dëshpërimi i tyre. Mungesa e strehimit adekuat, shërbimeve mjekësore dhe edukimit vazhdojnë ciklin e pashpresë. Disa gra përfundojnë duke lënë komunitetet e tyre për të kërkuar punë ose për të shpëtuar nga mizori dhe vështirësitë në shtëpitë e tyre, vetëm për t'u abuzuar nga të huajt ose për t'u detyruar të prostitutojnë.

Miliona romë i janë shmangur të qënurit më të varfërit e të varfërve në disa vende të Evropës Qendrore dhe Lindore. Gratë dhe fëmijët romë janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj shitjes në skllavëri. Shumë romë nuk mund të lexojnë ose nuk kanë energji elektrike në shtëpitë e tyre, kështu që radioja është mjeti më i mirë për t'i mësuar këto komunitete me gojë rreth dashurisë së Perëndisë për ta. Shumë fshatra romë janë plot me dëgjues të përkushtuar të programeve të TWR-së, të cilët kanë filluar grupet e lutjes dhe kishat lokale.

Në vendet ish komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore, radioja e krishterë i ndihmon kishat ungjillore duke ofruar mësim të shëndoshë dhe mësim moral për ata që u mësuan për shumë vite që Perëndia nuk ekzistonte. Radioja mund të arrijë edhe ata që janë ende të izoluar nga kulturat, familjet dhe fetë e tyre, duke i ndihmuar ata të kuptojnë Perëndinë dhe të gjejnë shpresë tek Jezusi.

Të lutemi për gratë në Evropën Qendrore dhe Lindore



Dëgjoni kalendarin e lutjes online në
twr-albania.com

Dëgjoni programin "Shprese per ty" në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe
17:00



Të lutemi për...

1. Gratë në Evropën Qendrore dhe Lindore për të zbuluar jetë të re në Krisht dhe për të përjetuar bekimet e shumta që Perëndia u ofron bijave të tij. “Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja” (2 Korintasve 5:17).

2. Të krishterët që të flasin me guxim dhe të rrisin ndërgjegjësimin për martesat e rrezikshme të fëmijëve dhe për shumë gra që përjetojnë dhunë të tmerrshme në familje ose trafik njerëzor

3. Skuadrat “Shpresë për ty”, ndërkohë që u mësojnë grave parimet morale biblike, të cilat pastaj ua mësojnë fëmijëve të tyre se çfarë do të thotë të kesh gëzim të vërtetë edhe në rrethana të këqija. “Tregoni kujdes se mos ndokush ju bën prene e tij me anë të filozofisë dhe me mashtrime të kota, sipas traditës së njerëzve, sipas elementeve të botës dhe jo sipas Krishtit,” (Kolosianëve 2:8).

4. Shpresën e Krishti të zëvendësojë ndjesinë dërmuese të mospasjes shpresë në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore midis romëve, muslimanëve dhe ateistëve.

5. Producentin e programit të kalendarit të lutjes në Shqipëri dhe mijëra dëgjues të cilët janë të inkurajuar nga ky rrjet lutjesh, e cila është e vetmja kishë që kanë disa të krishterë të izoluar.

6. Urtësi dhe kreativitet për udhëheqësit e 50 grupeve të lutjes së grave në Shqipëri. Nevojat e shumë të papunëve janë të mëdha, dhe materialet e trajnimit të aftësive dhe literatura biblike janë të pakta.

7. Ata që punojnë me vejushat jo vetëm duke i këshilluar, por edhe duke u dhënë atyre një perspektivë krejtësisht të re sipas të vërtetave të Fjalës së Perëndisë. “Feja e pastër dhe pa njollë përpara Perëndisë dhe Atit është kjo: të vizitosh jetimët dhe të vejat në pikëllimet e tyre dhe ta ruash veten të pastër nga bota.” (Jakobi 1:27).

8. Të lutemi për ata 10 milion romë që jetojnë në Evropë, shumica e tyre në varfëri.

Sipas U.N. dy të tretat e të rinjve të tyre janë të pa punë ose jashtë shkollës. Pothuajse gjysma e vajzave romë të moshës 15-19 vjeç janë të martuara ose në një lidhje.

9. Programet “Shpresë për ty” në gjuhët romë në Shqipëri dhe në gjuhën romë në Bullgari që të sigurojnë ndihmë për dëgjuesit romë që janë analfabetë, sepse varfëria dhe martesat në moshë të vogël i mbajnë vajzat larg nga arsimimi dhe edukimi.

10. Komunikim të mirë dhe përkushtim të patundur që të triumfojnë në martesat në Shqipëri, Bjellorusi, Bullgari, Rusi dhe vende të tjera evropiane.

11. Të krishterët që të kujdesen për të humburit dhe njerëzit që kërkojnë të shkojnë në kishë, pavarësisht nga prejardhja e tyre shoqërore.

12. Gratë e krishtera për tu rritur në rolin si udhëheqëse në shërbesën e grave të TWR-së në Bullgari dhe për burimet që të ofrohen për të filluar shërbesën në Lituani dhe Serbi.

13. Dituri dhe forcë për anëtarët e grupit kroat “Shpresë për ty” të TWR-së, në mënyrë që ata të mund të balancojnë kohën e tyre me familjet e tyre, shërbesën e kishës dhe me punën me orar të plotë.

14. Zemrat e secilit person që viziton faqen e internetit dhe atë të Facebook-ut të TWR-së dhe dëgjon programin “Shpresë për ty” që Fryma e Shenjtë të punojë në ta. Vizitorët e faqes janë nga Kroacia, Australia, Austria, Bosnja, Kanadaja, Gjermania, Maqedonia, Mali i Zi, Suedia, Zvicra, U.K dhe SHBA.

15. Gratë që luten për bashkëshortët, djemtë dhe vëllezërit e tyre të përfshirë në lojërat e fatit. Lutuni që Fryma e Shenjtë të punojë në zemrat dhe mendjet e këtyre burrave.

16. Mbështetësit e shërbesës “Shpresë për ty” që japin me sakrificë në mënyrë që gratë në Evropën Qendrore dhe Lindore të kenë mundësinë të dëgjojnë për Perëndinë. “Sepse kryerja e kësaj shërbesë të shenjtë jo vetëm përbush nevojat e shenjtorëve, por sjell edhe një mbushulli falënderimesh ndaj Perëndisë” (2 Korintasve 9:12).

17. Gratë që abuzohen nga kulturat, familjet dhe fetë e tyre. Kërkojini Perëndisë t’i ndihmojë ato të kuptojnë se sa i vlerëson ato dhe se si Fryma e Shenjtë mund t’i ndihmojë.

18. Udhëheqësit e kishës që të jenë të vetëdijshëm për përhapjen e rrezikshme të trafikimit seksual, në mënyrë që ata të paralajmërojnë familjet dhe t’u sjellin shërim viktimave.

19. Familjet e thyera nga divorci dhe për shumë nëna beqare të vetmuara që po luftojnë për të mbështetur dhe rritur fëmijët e tyre.

20. Radiodramën “Thesare të fshehura” të TWR-së, bërë për gratë e shfrytëzuara dhe të trafikuar seksualisht. Versioni në anglisht i 10 episodeve është përkthyer në gjuhën shqipe, bullgare, hungareze, rumune dhe ruse. Lutuni për prodhimin çek, i cili është ende në proces.

21. Ndërmjetësuesit në Poloni që luten për fonde për të filluar prodhimin e programit “Shpresë për ty” në polonisht që shumë të mund të dëgjojnë për shpresën që Jezusi i ofron.

22. Zyra e TWR-së në Poloni që të regjistrohet si një organizatë me këshilltarë ligjorë të krishterë dhe të ketë qasje për të ndihmuar jetimët, të burgosurit dhe familjet që luftojnë për të përbushur nevojat e tyre themelore. “Kujtoni të burgosurit si të ishit të lidhur bashkë me ta, dhe ata që keqtrajtohen, sepse edhe ju vetë jeni në trup.” (Hebrenjve 13: 3).

23. Dëgjuesit rumunë të “Shpresë për ty” në Rumani dhe Moldavi për të zhvilluar një marrëdhënie personale me Perëndinë dhe për të lejuar Frymën e Shenjtë t’i fuqizojë ata që të arrijnë tek gratë e tjera që kanë nevojë për dashurinë e Krishtit.

24. Mundësi në Rumani për “Shpresë për ty” për të përhapur shpresën e Krishtit në mesin e grave të burgosura dhe refugjatëve, si dhe grupeve të tjera të pafavorizuara.